

➤ **Je i punësuar në bujqësi dhe je pushuar nga puna ose kontratës tënde i ka skaduar afati?**

➤ **Mund të kesh të drejtën e kompensimit për papunësi në bujqësi. Kërkesën duhet ta bësh brenda datës **31 mars****

**Kush janë punëtorët e interesuar?**

- ✓ Punëtorët me kohë të përcaktuar (O.T.D.).
- ✓ Punëtorët me kohë të papërcaktuar (O.T.I.).

Në qoftë se je punonjës imigrant duhet të kesh lejeqëndrim për punë të varur, ose në pritje për punësim.

**Në cilat raste e ke të drejtën e kompensimit për papunësi?**

- ✓ Pushim nga puna. ✓ Mbarim i afatit të kontratës.

Nëse je punonjës imigrant me marrëdhënie të varura pune dhe e ke humbur vendin e punës, mund të regjistrohesh në listat emërore të punës të Qendrës për Punësim, për periudhën e vlefshme të mbetur të lejeqëndrimit e gjithësesi për të paktën një vit. Mos harro se, për pritje punësimi, mund të marrësh lejeqëndrim, i cili mund të ripërtërihet. Para skadimit të lejeqëndrimit tënd, kalo nga zyrat tona për të mësuar të gjitha informacionet e nevojshme.

**Mund të kesh të drejtën e shërbimeve të mëposhtme**

- ✓ Kompensim për papunësi në bujqësi: kërkesa i duhet paraqitur Inps-it vetëm në mënyrë telematike. Ky veprim mund të bëhet pranë zyrave tona.

**Kur mund ta paraqesësh kërkesën?**

- ✓ Kërkesa duhet paraqitur brenda datës 31 mars të vitit pas atij të pushimit nga puna ose të skadimit të afatit të kontratës. ✓ Pra, brenda 31 marsit duhet të paraqesësh kërkesën për kompensim për vitin e mëparshëm, përndryshe e humb të drejtën.

**Në cilat raste nuk e ke të drejtën e kompensimit për papunësi?**

- ✓ Dorëheqje e vullnetshme nga puna (përveç, në kushte të përcaktuara saktë, punonjëseve nëna gjatë vitit të parë të fëmijës). ✓ Në rast se je punonjës imigrant me lejeqëndrim për punë stimore (nga 20 ditë deri në 9 muaj, por me detyrimin e rikthimit në atdhe).

